



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Oda e infermiereve, mamive dhe profesionistve tjere shendetesore

Në bazë të nenit 47 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150, dhe të Statutit të Odës të infermiereve, mamive dhe profesionistve tjerë shendetesore të Kosovës, Kuvendi i Odës së infermiereve, mamive dhe profesionistve tjere shendetesore në mbledhjen e vet të mbajtur më 03.05.2017 miratoi :

**RREGULLOREN PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE TË ODËS SË
INFIERMIERVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTVE TJERE SHENDETESORE**

Neni 1

Procedura për shfrytëzimin e Fondit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke

Komisioni për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke harton procedura dhe përcakton kriteret për shfrytëzimin sa më efikas të Fondit financiar në kuadër të OIK-ut, i cili fond shfrytëzohet vetëm nga anëtarët e OIK-ut –së dhe nga anëtarët e familjes së ngushtë të tyre.

Neni 2

E drejta e aplikimit për shfrytëzimin e Fondit të Ndhimës Solidare dhe Ndhimës Reciproke

Çdo anëtar i OIK-utë ka të drejtë të aplikoj për shfrytëzimin e Fondit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke për vete dhe për anëtarët e famijes së ngushtë të tij.

Neni 3

Kriteret për dhënien e Ndhmës Solidare dhe Ndhmës së Reciprocitetit

Kriteret për dhënien e Ndhmës Solidare dhe Ndhmës së Reciprocitetit janë:

- ✓ Sëmundjet e antarëve të OIK-ut dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre
- ✓ Fatkeqësit e natyrave të ndryshme
- ✓ Nevoja emergjente materiale
- ✓ Nevoja të tjera shtesë

Neni 4

Burimet e financimit të Fondit të Solidaritetit dhe Ndhmës Reciproke

Fondi i Solidaritetit dhe Ndhmës Reciproke financohet nga buxheti i OIK-ut në pajtim me rregulloren për të hyrat dhe shpërndarjen e të hyrave të OIK-ut, dhe nga donacionet dhe aktivitetet e tjera legale të OIK-ut.

Neni 5

Komisioni është i obliguar që në afat më së largu prej 10 ditëve të punës kalendarike të shqyrtoj aplikacionin, përjashtim bëjnë rastet urgjente për të cilat kërkohet të mirren vendime në një kohë sa me të shkurtër, në pajtim me Këshillin Drejtues.

Neni 6

Anëtari i OIK-ut që ka aplikuar për shfrytëzimin e Fondeve Solidare dhe Ndhmës Reciproke ka të drejtën e ankesës te Këshilli Drejtues në afat prej brenda 15 ditësh nga marrja e vendimit.

Neni 7

Procedurat e përgjithshme administrative

Realizimi i të drejtave në Fondin e Solidaritetit dhe Ndhmës Reciproke bëhet në pajtim me procedurat e përgjithshme administrative.

Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin kur aprovohet nga amtaret e OIK-ut

Prishtine 03.05. 2017

Naser RRustemaj

Kryetari i OIK
